



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/18

Datë: 29.07.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 korrik 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet procesverbali dhe transkripti i mbledhjes së 8-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/18

Datë: 29.07.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 korrik 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për nënshkrimin e marrëveshjes financiare trepalëshe mes Bashkimit Evropian, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut për vitin 2020, për programin e Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA II mes Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit të ndërmarrë të gjitha hapat në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim të finalizimit të marrëveshjes.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/18

Datë: 29.07.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 3 të Ligjit Nr. 03/L-220 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-112 për Tatimin e Normës së Akcizës në Kosovë, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 korrik 2020, merr këtë:

V E N D I M

- Vendoset norma e tatimit të akcizës në duhan sipas këtij Kalendarit:
 - Nga data 1 shtator 2020 vendoset norma e tatimit të akcizës për kodin tarifor 240220 "cigaret që përmbajnë duhan" në shumën prej dyzet e tetë euro (48€) për njësi konvencionale;
 - Nga data 1 janar 2021 vendoset norma e tatimit të akcizës për kodin tarifor 240220 "cigaret që përmbajnë duhan" në shumën prej dyzet e nëntë euro (49€) euro për njësi konvencionale;
 - Nga data 1 janar 2022 vendoset norma e tatimit të akcizës për kodin tarifor 240220 "cigaret që përmbajnë duhan" në shumën prej pesëdhjetë e një euro (51€) për njësi konvencionale;
 - Nga data 1 janar 2023 vendoset norma e tatimit të akcizës për kodin tarifor 240220 "cigaret që përmbajnë duhan" në shumën prej pesëdhjetë e tre euro (53€) për njësi konvencionale; dhe
 - Nga data 1 janar 2024 vendoset norma e tatimit të akcizës për kodin tarifor 240220 "cigaret që përmbajnë duhan" në shumën prej pesëdhjetë e pesë euro (55€) për njësi konvencionale.
- Obligohet Ministria e Financave dhe Dogana e Kosovës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim i dërgohet Komisionit për Buxhet dhe Financa, për konsultim.
- Ky vendim hyn në fuqi më 1 shtator 2020 dhe shfuqizon të gjitha vendimet e mëparshme të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me akcizën në duhan.

Avdullah HODI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/18
Datë: 29.07.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 korrik 2020, merr këtë:


V E N D I M

Për hartimin e Programit për Reforma Ekonomike 2021-2023

1. Qeveria e Republikës së Kosovës përgatitë Programin për Reforma Ekonomike 2021-2023 (në vijim PRE), si pjesë e dialogut ndërmjet BE-së dhe Republikës së Kosovës në kuadër të qeverisjes ekonomike.
2. PRE mbulon periudhën afatmesme tri vjeçare 2021-2023 dhe bazohet në kornizën makro-fiskale, prioritetet e reformave strukturore, masat përkatëse që janë pjesë e Programit të Qeverisë 2020-2023 dhe Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021.
3. Duke u bazuar në Udhëzimet e Komisionit Evropian, përmes Programit për Reforma Ekonomike raportohet për zbatimin e rekomandimeve nga Konkluzionet e përbashkëta të Dialogut Ekonomik dhe Financiar në mes BE-së dhe Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë të datës 19 maj 2020.
4. Ministri/ja i/e Financave koordinon procesin e hartimit të PRE në cilësinë e Koordinatorit Nacional të Programit për Reforma Ekonomike.
5. Koordinatori Nacional i Programit për Reforma Ekonomike mbështetet nga:
 - 5.1. Zyra për Planifikim Strategjik e Zyrës së Kryeministrit (ZPS) për agjendën e reformave strukturore, që përfshijnë politikat publike sipas fushave të përcaktuara me udhëzimet e Komisionit Evropian;
 - 5.2. Departamenti për Politika Ekonomike, Publike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar (Ministria e Financave) lidhur me kornizën makro-ekonomike dhe politikat fiskale, duke përfshirë masat mbështetëse fiskale; dhe
 - 5.3. Ministrinë e tjera të linjës në varësi të temave që trajtohen në PRE.
6. Sipas udhëzimeve të Koordinatorit Nacional, ZPS fton ministrinë e linjës dhe institucionet tjera sipas fushave të përcaktuara me Udhëzuesin e Komisionit Evropian për të kontribuar në procesin e hartimit dhe takimet e punës së Programit për Reforma Ekonomike.
7. Sipas fushave të përcaktuara nga Komisioni Evropian, Koordinatori Nacional, fton Sekretarët e përgjithshëm të Ministrive/Institucioneve përkatëse, të emërojnë koordinatorët e fushave, të cilët janë përgjegjës të japin kontributin e tyre në hartimin e prioritetëve të reformave strukturore të PRE-së.

8. Koordinatorët e emëruar nga Sekretarët e përgjithshëm të ministritë përgjegjëse për fushat e mëposhtme, përbëjnë ekipin qendror të procesit të hartimit të reformave strukturore të PRE-së:
 - 8.1. Reformat në tregun e Energjisë dhe Transportit;
 - 8.2. Bujqësia, Industria dhe Shërbimet;
 - 8.3. Mjedisi biznesor dhe zvogëlimi i ekonomisë informale;
 - 8.4. Hulumtimi, zhvillimi dhe inovacioni (HZHI) dhe Ekonomia Digjitale;
 - 8.5. Reformat për Integrimin Ekonomik;
 - 8.6. Arsimi dhe shkathhtësitë;
 - 8.7. Punësimi dhe Tregu i punës;
 - 8.8. Gjithëpërfshirja dhe mbrojtja sociale.
9. ZPS udhëheqë procesin e monitorimit të zbatimit të prioriteteve të reformave Strukturore si dhe Konkluzioneve të përbashkëta të dala nga takimi në mes të Bashkimit Evropian dhe Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë, ku përmes koordinatorëve të fushave të përcaktuara nga Komisioni Evropian do të bëjë grumbullimin e të dhënave dhe hartimin e raportit të zbatimit të PRE-së.
10. Në procesin e hartimit të PRE ftohen gjithashtu përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, sektorit privat dhe partnerëve të tjerë për të dhënë kontributin e tyre në përzgjedhjen e prioriteteve të reformave strukturore.
11. Duke u bazuar në këtë vendim, ZPS në koordinim me Koordinatorin Nacional për PRE do të përgatis një kalendar të procesit të hartimit të PRE-së dhe do ta ndajë atë me ministritë përkatëse.
12. Prioritizimi i masave të Programit për Reforma Ekonomike 2021-2023, pasi që masat të përgatiten nga koordinatorët sektorial dhe shqyrtohen nga Zyra për Planifikim Strategjik, do të bëhet nga Komisioni për Planifikim Strategjik.
13. Drafti final i Programit për Reforma Ekonomike 2021-2023 aprovohet nga Komisioni për Planifikim Strategjik para se të dërgohet për miratimin përfundimtar në Qeveri.
14. Koordinatorin Nacional e prezanton draftin e PRE-së për konsultim publik (të jashtëm) përmes platformës për konsultime publike dhe gjithashtu me partnerët social, komunitetin e bizneseve, asociacionet dhe sindikatat, shoqërinë civile, pushtetin lokal dhe komisionet përkatëse parlamentare.
15. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/18
Datë: 29.07.2020


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 korrik 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Me qëllim të zbatimit të pikës Nr. 4.8 të Vendimit Nr. 01/10, datë 05.07.2020, i Qeverisë së Republikës së Kosovës, përcaktohen shtesat dhe kriteret si në vijim:
 - 1.1. Aprovohet shtesa mujore mbi pagë në vlerë prej treqind (300 €) euro vetëm për personelin publik shëndetësor (në listën e pagave) sipas pikës 1.2. të këtij Vendimi për angazhim shtesë, për ekspozim të drejtpërdrejtë rrezikut të infektimit në punën e tyre sipas kriterëve nga pika 1.2 e këtij vendimi, gjatë trajtimit të pacientëve lidhur me virusin COVID-19, për muajin Korrik dhe Gusht 2020.
 - 1.2. Kriteret bazike dhe procedurat e përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë (MSH) për përfituesit e kësaj shtese të cilët kanë qenë aktiv në periudhën Korrik-Gusht, janë si në vijim:
 - 1.2.1. Mjekët të cilët janë marr direkt me trajtimin e pacientëve me Covid-19; dhe
 - 1.2.2. Infermierët dhe teknikët të cilët janë marr me trajtimin direkt të pacientëve me Covid-19.
 - 1.3. Institucionet (organizatat buxhetore/programet), stafi i të cilëve përfiton nga kjo shtesë janë si në vijim:
 - 1.3.1. Programet IKSHPK, QKTGJ dhe Departamenti i Burgjeve të Ministrisë së Shëndetësisë;
 - 1.3.2. SHSKUK me Programet Spitalet Regjionale;
 - 1.3.3. QKMF-të në kuadër të komunave;
 - 1.4. Autorizohet Ministria e Shëndetësisë që në zbatim të kriterëve bazike nga pika 1.2 e këtij vendimi, të lëshojë udhëzime plotësuese me shkrim si dhe të mbikëqyr zbatimin e tyre në përputhje me këto kriterë.

- 1.5. Organizatat buxhetore janë përgjegjëse të përgatisin dhe të aprovojnë me shkresë përmes ZKA dhe ZKF të organizatës listat e personelit të tyre shëndetësor në përputhje me pikën 1.1 dhe 1.2 dhe të njëjtat përcillen në Ministrinë e Shëndetësisë, e cila pasi konstaton përputhshmërinë me kriteret e këtij vendimi dhe udhëzimet e saj, përmes Ministrit dhe Sekretarit të Përgjithshëm me shkresë të veçantë i dërgon në Thesarin e Kosovës (MF) për procesim përmes Sistemit të Pagave, përkatësisht pagesë retroaktive për dy muaj, së bashku me pagën mujore të muajit Gusht 2020.
2. Për zbatimin e këtij vendimi Thesari i Kosovës (MF) bën alokim të parakohshëm nëpër linjat buxhetore të organizatave buxhetore sipas pikës 1 të këtij vendimi nëpërmjet kodit '00099', në programet/nën-programet ku bëhet ekzekutimi i pagave të rregullta.
3. Mjetet buxhetore për zbatimin e këtij vendimi sigurohen nga kursimet e brendshme të organizatave buxhetore të cilat ndikohen nga zbatimi i këtij vendimi, përkatësisht kompensojnë linjat buxhetore nga zbatimi i pikës 2 të këtij vendimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Ministria e Financave obligohet që koston buxhetore nga zbatimi i këtij vendimi si dhe në përputhje me pikën 3 të tij, ta trajtojë në procesin e harmonizimeve të ndarjeve buxhetore në tremujorin e fundit të vitit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
5. Obligohet Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave dhe organizatat buxhetore sipas pikës 1.2.2 të këtij vendimi të sigurojnë zbatueshmëri të plotë të vendimit, në pajtim me legjislacionin në fuqi.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/18

Datë: 29.07.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 3, 4, 9 dhe 10 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 korrik 2020, merr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i projektit - Themelimi i Qendrës Përkujtimore për Gjenocidin mbi Shqiptarët "Bllaca 1999" Komuna Hani i Elezit, sipas tabelës të përshkruar nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarin e pronës së paluajtshme, pozitën e saj në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqes së saj, e cila tabelë është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij vendimi preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej 10 ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës, si dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.
3. Kundër këtij vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky vendim.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit, Ministria e Financave dhe Komuna e Hanit të Elezit.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/18

Datë: 29.07.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4, 9, 10, 44 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 korrik 2020, merr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi i Rrugës Nacionale N2 Prishtinë-Mitrovicë, Segmenti Gojbulë-Smrekovnicë Loti I, zonat kadastrale: Smrekovnicë, Dobërlukë, Bajskë, Sllatinë (Gjelbrishtë), Vushtrri dhe Gojbulë të Komunës së Vushtrrisë, sipas tabelave të përshkruar nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, të cilat tabela janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij vendimi preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej 10 ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës, si dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.
3. Kundër këtij vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky vendim.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit, Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Financave dhe Komuna e Vushtrrisë.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/18

Datë: 29.07.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 3, 4, 9, 10 dhe 44 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 korrik 2020, merr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme ish shoqërore për nevoja të realizimit të Projekteve të Komunës së Drenasit:
 - Ndërtimi i "Lokacionit për Varreza", parcela nr. 522 ZK Zabel i Ulët,
 - Ndërtimi i Lokacionit të "Tregut të Kafshëve", ngastrat kadastrale nr. 893-4, ZK Drenas dhe 325-1 ZK Çikatovë e Re,
 - Zgjerimi i "Zonës Ekonomike në Drenas" parcela nr. 29 ZK Koreticë e Epërme,
 - Ndërtimi i Impiantit për Ujra të Zeza dhe Industriale të Parkut të Biznesit-Drenas dhe Kanalizimi i fshatit, parcelat 132-0 ZK Koreticë e Epërme dhe 522-0 ZK Zabel i Ulët, të gjitha në Komunën e Drenasit, sipas tabelave të përshkruar nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, të cilat tabela janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij vendimi preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej 10 ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës, si dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.
3. Kundër këtij vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotëruar i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky vendim.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit, Ministria e Financave dhe Komuna e Drenasit.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/18

Datë: 29.07.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 45 paragrafit 1. të Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 korrik 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti Gjashtëmuor i Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2020.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Raportin nga pika 1. e këtij vendimi ta dorëzoj në Kuvendin e Republikës së Kosovës konform kërkesave të nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me plotësimet dhe ndryshimet e bëra.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë